

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjermania do të dërgojë 1 mijë ushtarë aktivë në Lituani – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/gjermania-do-te-dergoje-1-mije-ushtare-aktive-ne-lituani/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 14:58:16 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 14:56:41 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8d953f723a9e72b954f2f80080a2bc5d66dc5173808684b0464b8f79be4834b0
TEKSTI	4dcbe698463dcc7236b7e39f5a93c439d6379a894a2c83fc228af27ef303d808
PAMJA	84eab0201ac25c7ea9c55b4ce8be1ba1041927bb3547603ca0e9196064734cff

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	fc889f9ec66339af070fba9b3169f2f31d158f48a7a4f94328a502033b1c7042
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e0b9829abbee6aeaf0cbffff89c7cd5e0dcc89e0fb08f67fff94e9a06c82fe2c5
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/fc889f9ec66339af070fba9b3169f2f31d158f48a7a4f94328a502033b1c7042>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



një konflikti të mundshëm me Rusinë.

Sipas gazetës gjermane Bild, ministri i Mbrojtjes, Boris Pistorius, ka miratuar vendosjen e detyrueshme të një pjese të personelit të Bundeswehr, pasi ushtria gjermane nuk ka arritur të sigurojë numrin e nevojshëm të vullnetarëve për brigadën në Lituani.

Transferimet e para mund të nisin këtë vjeshtë dhe pritet të përfshijnë më pak se 1,000 ushtarë. Masa nuk përbën mobilizim të përgjithshëm dhe nuk lidhet me rikthimin e rekrutimit të detyrueshëm të civilëve, por vetëm me personelin aktiv të Bundesëehr-it, i cili mund të urdhërohet të shërbejë në Lituani edhe nëse nuk është paraqitur vullnetarisht për misionin.

Deri tani, rreth 60% e pozicioneve të kërkuara për brigadën janë plotësuar në mënyrë vullnetare. Mungesat më të mëdha janë evidentuar te specialistët e IT-së, personeli i logjistikës, kuzhinierët dhe pushkëtarët.

Sipas Bild, vendosjet e detyrueshme mund të prekin aktualisht deri në 20% të pozicioneve të brigadës. Bundesëehr synon që kjo shifër të ulet në rreth 10% deri në fund të shtatorit, duke tërhequr më shumë ushtarë vullnetarë.

Ushtria gjermane ka zhvilluar ndërkohë fushata rekrutimi dhe ka organizuar edhe udhëtime njohëse në Lituani për ushtarët dhe familjet e tyre. Megjithatë, për shkak të afateve për krijimin e brigadës, autoritetet gjermane duhet të marrin së shpejti vendime për pozicionet që mbeten vakante.

Ushtarët që do të preken nga vendosja e detyrueshme duhet të njoftohen

dunëj të kthenej sot, Aiket Rizai...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emaili juaj

Abonohu

zyrtarisht dhe do të kenë mundësi të kundërshtojnë vendimin në rrugë ligjore, ndërsa duhet t'u lihet edhe koha e nevojshme për të organizuar zhvendosjen.

Gjermania planifikon të stacionojë në mënyrë të përhershme rreth 4,800 ushtarë dhe 200 punonjës civilë në Lituani deri në fund të vitit 2027.

Brigada e 45-të e Blinduar Lituanëze do të jetë njësia e parë luftarake gjermane e vendosur përgjithmonë jashtë vendit që nga krijimi i Bundesëehr-it në vitin 1955.

Brigada, e cila do të ketë rreth 5,000 trupa dhe mjete të shumta ushtarake, është pjesë e përpjekjeve të NATO-s për forcimin e krahut lindor pas pushtimit rus të Ukrainës në vitin 2022.

Pozicioni i Lituaniës është strategjik, pasi vendi kufizohet me Bjellorusinë dhe enklavën ruse të Kaliningradit. Gjithashtu, ai ndodhet pranë korridorit Suëalki, një zonë e ngushtë që lidh Poloninë me shtetet baltike dhe që konsiderohet një pikë e ndjeshme në rast të një konflikti të mundshëm me Rusinë.

Vendimi i Berlinit vjen në një periudhë të rritjes së shqetësimeve për sigurinë në Evropën Lindore. Polonia ka shtuar gjithashtu masat e sigurisë pas incidenteve të lidhura me sulmet ruse pranë territorit të saj.

Kryeministri polak Donald Tusk ka paralajmëruar se përshkallëzimi i veprimeve ruse mund të prekë edhe vendet anëtare të NATO-s që ndodhen pranë Ukrainës.

Sipas Tusk, javët dhe muajt e ardhshëm mund të shoqërohen me një aktivitet shumë intensiv nga ana e Rusisë, duke e bërë forcimin e gatishmërisë ushtarake një çështje gjithnjë e më të rëndësishme për vendet e aleancës.



Xhuljana Zhuleku

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh



BOTA

Sulmi me dron pranë Polonisë,...

Xhuljana Zhuleku

3 orë më parë



BOTA

Kërkohen të zhdukurit në Indonezi, anija m...

Xhuljana Zhuleku

3 orë më parë



BOTA

Rezultat i ngushtë në Suedi,...

Xhuljana Zhuleku

5 orë më parë

Lini një koment

Komenti juaj *

Me respekt — komentet moderohen nga redaksia.

Emri *

E-mail *

Nuk publikohet kurrë.

☐ Ruaje emrin dhe e-mailin tim në këtë shfletues për herën tjetër që komentoj.

Posto komentin



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.